



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 229/3 prot.,

Datë 01.02.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*BIOCHEM NRP*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar*” - *Mallra, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj*”, me Nr. *REF-89520-12-04-2023*, me objekt: “*Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH Tiranë*”, me fond limit 7.992.867 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 10.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “*BIOCHEM NRP*” SHPK me NIPT: K31404135W, dhe me adresë: *Rruga "Shkëlqim Fusha", Pallati "Al Konstruksion", Kati 1, Zona Kadastrale 3292, Numër Pasurie 102/14-N5, Selitë, Farkë, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë
Adresa: Rruga: "Qamil Guranjaku", Tiranë.

Në datën 31.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 229/2024 protokoli, datë 31.01.2024 e operatorit ekonomik “*BIOCHEM NRP*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar*” - *Mallra, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj*”, me Nr. *REF-89520-12-04-2023*, me objekt: “*Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH Tiranë*”, me fond limit 7.992.867 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 10.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*BIOCHEM NRP*” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “BIOCHEM NRP” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 229/2024 prot., datë 31.01.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Bazuar ne nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 3/g ku citohet se.... 3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi... rezulton se distributori i autorizuar per Shqiperine eshte i perjashtuar nga APP per te marre pjese ne procedura prokurimi dhe ka autorizuar nje kompani pf per te shitur produktet e saj, dhe kompania pf e autorizuar ka autorizuar kompanine qe aktualisht eshte ofertuese ne kete procedure.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.02.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro